


Rikonstruksioni i Galeris “Nikolet Vasia”  
Relacion Arkitektonik

BASHKIA DURRES



**RELACION ARKITEKTONIK**


**Objekti: RIKONSTRUKSION GALERIA E ARTIT PAMOR “NIKOLET VASIA”**

**BASHKIA DURRES  
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURES PUBLIKE  
Shkurt 2024**

INFORMACION I PERGJITHSHEM

**-HYRJE**

Galeria e artit "Nikolet Vasia" në qytetin e Durrësit është një galeri e artit pamor e cila ka marrë emrin Nikolet Vasia, nipit të Kol Idromenos, piktorit që ka lënë pas shumë veprat artistike . Kjo Galeria ndodhet përballë Bashkisë Durrës ,në rrugën "Aleksandër Goga" dhe është pjesë e sheshit të Xhamisë së qytetit .



## Rikonstrukcioni i Galeris "Nikolet Vasia" Relacion Arkitektonik

Në projekt synohet që të përmirsohet cilësia e Galerisë së Artit , si nga ana teknike , funksionale ashtu edhe nga ana estetike vizuale.

Aktualisht kjo galeri ka shumë problematika të cilat përfshijnë lagështinë , vizibilitetin , organizimin e brëndshëm,sistemin elektrik dhe ndricimin , sistemin e aspirimit dhe kondicionimit,etj


Një nga problemet kryesore është uji I shiut i cili depërton në brendësi të galerisë prej trotuarit si pasojë e mungesës së hidroizolimit dhe si pasojë e kuotës së njejtë të trotuarit me dyshemënë e brëndshme të galerisë. Vihet re se uji i shiut ka krijuar shumë lagështi dhe dëmtim në tavanin e gipsit si pasojë e dëmtimit të hidroizolimit në tarracën e objektit dhe të kunetës që bën mbledhjen e ujërave të shiut në këtë tarracë e cila gjithashtu është pjesë e sheshit përpara xhamisë së qytetit . Sistemi I ndricimit gjithashtu ka nevojë për përmirsim pasi ndodhet ne gjendje të amortizuar. Një tjetër problem është sistemi I aspirimit dhe kondicionimit.

Foto te gjendjes aktuale





Rikonstruksioni i Galeris "Nikolet Vasia"  
Relacion Arkitektonik



Rikonstrukcioni i Galeris "Nikolet Vasia"  
Relacion Arkitektonik

Në këtë galeri hasemi me problemin e vizibilitetit që do të thotë se ajo çfarë ekspozohet brenda është mjaftueshëm e dukshme nga jashtë, gjë që nuk është e përshtatshme për ekspozimin e veprave të artit, për shkak të vetrates së xhamit.

Një problematikë është mungesa e një recepsioni, një ambjent pritje, një posti të përshtatshëm pune, dhe një hyrje të mirëorganizuar.

Sistemi i ndicimit ka nevojë për përmirsim dhe gjithashtu sistemi elektrik si dhe vendosja e prizave dhe celsave përkatës.

Një tjetër problem është sistemi i aspirimit dhe kondicionimit i cili është jo funksional.

Sistemi i ekspozimit të veprave të artit brenda galerisë ka nevojë për përmirsim dhe gjithashtu nevojiten panele për vendosjen e njoftimeve të ekspozitave, të cilat do të vendosen në hapsiren e jashtme të ndërtesës duke i shërbyer kështu kalimtarve dhe të gjithë personave të interesuar mbi ekspozitat e artit.

### **Nderhyrjet ne objekt**

Projekti për rikonstrukcionimin e Galerisë së Artit Pamor përfshin disa ndërhyrje duke filluar nga prishjet e suvatimeve ,hidroizolimi i taracës, sistem i ri elektrik , aspirimi dhe kondicionimi etj.

Mureve të brendshme do të prishet rifinituara dhe do të bëhet rifinitura e re duke vendosur prizat dhe celsat në vendet përkatëse.

Ne objekt parashikohet një sistem i ri i aspirimit dhe kondicionimit.

Do të hiqet tavan i ekzistues i gipsit së bashku me sistemin e aspirimit duke u zëvendësuar kështu me një tavan të ri i cili do të jetë gips ,ku në zonen e gipsit do të inkastrohet sistemi i ri i aspirimit dhe ndricimit. Do të bëhet riparimi i tarracës së objektit e cila korrespondon edhe me sheshin përpara xhamisë. Do të hiqen shtresat ekzistuese si dhe do të bëhet riparimi kunetës që mbledh ujrat e shiut mbi tarace.

Gjithashtu një pjesë e parapeteve të xhamit që ndodhen mbi shesh janë të dëmtuara dhe këto do të zëvendësohen me parapete xhami të reja. Streha ekzistuese do të riparohet si pasojë e demtimeve të marra nga lageshtia dhe panelet veshës të saj do të zëvendësohen me panele të reja me material pvc.

Në lidhje me fasadën, aty ku xhami struktural është i demtuar do të zëvendësohet me xham të ri.

Në aspektin e organizimit të brendshëm, do të bëhet spostimi i hyrjes kryesore, ku do të organizohet dhe një recepsion së bashku me postin përkatës të punës dhe një ambjent pritje. Do të bëhet një zonim i vecuar i nyjeve higjienosantare dhe magazinës. Do të vendoset një sistem i ri për ekspozimin e veprave të artit duke anashkaluar kështu dëmtimin e mureve të ndërtesës.

Punoi :

Alba Kokomani

Eni Turkeshi

Lorenc Façja

Rikonstruksioni i Galeris “Nikolet Vasia”  
Relacion Arkitektonik